



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:915524
Datë: 07.03.2024
Numri i dokumentit: 05422598

C.nr.1301/23

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Fuad Haliti, në kontestin e paditëses Banka për Biznes me adresë në Rr. “Ukshin Hoti” nr.128 Prishtinë. Të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Exhmein Sinani, kundër të paditurit R.M me adresë në rr.”Kukësi” nr, 35, Mitrovicë, me objekt të kontestit pagim i borxhit nga kredia, jashtë seance me datë 07.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses Banka për Biznes në tërësi si e bazuar.
- II. **OBLIGOHEN** i padituri R.M nga Mitrovica që paditëses t’ia paguajnë borxhin në lartësi prej 8,126.17€, në emër të kredisë, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Arsyetim

Komfor nenit 423 paragrafi 4 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në mungesë të të paditurit.

1. Pretendimet e palëve

Paditësja me datën 16.12.2009 pranë kësaj gjykatë ka paraqitur padi me të cilën ka kërkuar kthimin e borxhit të kredisë të datës 28.02.2005 në shumë prej 4,000€ me afat kthimi prej 36 muaj, ndaj të paditurit R.M i cili ka qenë nënshkruar i kontratës së kredisë përkatësisht garantues për kredinë e marrë nga kredimarrësi Ismet Imeri.

Në padi dhe në shqyrtim gjyqësor i autorizuari i paditëses deklaroi se duke qenë se i padituri ka qenë nënshkruar i kontratës së kredisë të datës 28.02.2005 në bazë të cilës ka marrë kredi në shumën prej 4,000€ me afat kthimi prej 36 muaj, përkatësisht ka qenë garantues për kredinë e marrë nga kredimarrësi Ismet Imeri, i cili tashmë ka ndërruar jetë, paditësi e sqaron para gjykatës që interesi i saj juridik është që i padituri R.M të obligohet ta kthejë borxhin e mbetur në tërësi, me qëllimin që edhe aktgjykimi eventual i marrur nga kjo gjykatë të mund të ekzekutohet edhe

në procedurë përbarimore në rast se i padituri nuk do të përmbushte obligimin në mënyrë vullnetare. E njoftojmë gjykatën që shuma e kredisë së marrë ka qenë në vlerë prej 4,000€, ndërsa ka pasur edhe interes te kontraktuar e cila për 36 muaj ka kapur shifrën prej 641.84€, pra për këtë kredi është tërhequr shuma prej 4,000€ ndërsa në rast të pagesës së kredisë sipas kontratës bankës është dashur t'i kthehet shuma prej 4,641.84€. E njoftojmë gjykatën që deri me tani për këtë obligim janë bërë pagesa në shumën totale 3,242.84€, nga e cilat 2,601€ janë destinuar në emër të kryegjës ndërsa 641.84€ në emër të interesit të kontraktuar, borxhi me datën e sotme ku po prezantojmë në këtë seance është i specifikuar si në vijim: kryegjë e mbetur e pa paguar është shuma prej 1,399€ interes në vonesë i akumuluar shumën prej 2,332.21€ dhe kamat vonese shuma prej 730.01€, total borxhi i mbetur në vlerën prej 4,461.22€. Gjykatës i përcjellim qarkullimin e llogarisë bankare për periudhën 28.01.2005 deri me 14.12.2023 në të cilën janë të pasqyruara të gjitha transaksionet në përlllogari të klientit përkatësisht kredi-marrësi Ismet Imeri, po ashtu e bashkëngjisim si provë edhe kartelën e qarkullimit me transaksione të pasqyruara deri me datën 14.12.2023, këto dokumente kanë qenë të përgatitura për seanca të kaluara dhe i dorëzojmë sot në gjykatë njëkohësisht e njoftojmë gjykatën që nga data 14.12.2023 nuk asnjë pagese apo transaksion të bërë në llogarinë të klientit. Paditësi me prova të mjaftueshme ka dëshmuar para gjykatës që ndaj tij është e pa përmbushur shuma e borxhit në vlerën prej 4,461.22€ andaj kërkojmë nga gjykata që me aktgjykim meritore ta obligoj të paditurin R.M me nr. personal të letërnjoftimit: 1008334338 që ndaj paditësit të përmbush borxhin e mbetur të pa paguar në vlerën e cekur më lartë.

2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: Kontrata e kredisë me nr.43 e datës 28.01.2005; Garancioni me nr.43 i datës 28.01.2005; Vërtetimi i të dhënave për garantuesin e parë - R.M i datës 21.01.2005; Vërtetimi i të dhënave për garantuesin e dytë - Lindita Hasanin i datës 21.01.2005; Kartela e qarkullimit për Ismet Imeri, për periudhën 28.01.2005 e deri me dt.14.12.2023 dhe Plani i amortizimit të kredisë nr.43.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku duke gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e **bazuar**.

3. Faktet

Me leximin e Kontratës së Kredisë me numër 43 të datës 28.01.2005 gjykata vërtetoi faktin se i padituri R.M është garantuesi i parë për kredinë e marrur nga kredimarrësi Ismet Imeri dhe se i njëjti e ka nënshkruar këtë kontratë.

Me leximin e Garancionit me numër 43 të datës 28.01.2005 gjykata vërtetoi faktin se Gjykata Komunale Mitrovicë ka lëshuar garancion për punëtorin Ismet Imeri.

Me leximin e Vërtetimit të të dhënave për garantuesin e parë - R.M i datës 21.01.2005 gjykata vërtetoi faktin se R.M jep deklaratë me të cilën pranon që të marrë përsipër obligimet e kredisë pa kurrfarë procedure paraprake në rast të mospagesës nga ana kredimarrësit Ismet Imeri dhe këtë deklaratë e nënshkruan me vetëdëshirë dhe pa presion.

Me leximin e Vërtetimit të të dhënave për garantuesin e parë – Lindita Hasani i datës 21.01.2005 gjykata vërtetoi faktin se Lindita Hasani jep deklaratë me të cilën pranon që të marrë përsipër obligimet e kredisë pa kurrfarë procedure paraprake në rast të mospagesës nga ana kredimarrësit Ismet Imeri dhe këtë deklaratë e nënshkruan me vetëdëshirë dhe pa presion.

Me leximin e Kartelës së Qarkullimit për Ismet Imeri, për periudhën 28.01.2005 e deri me 14.12.2023 gjykata vërtetoi se i njëjti nuk e ka paguar borxhin kontestues.

Me leximin e Planit të amortizimit të kredisë numër 43 gjykata vërtetoi se kredimarrësi Ismet Imeri borxhin kryesor e ka në vlerë prej 4,000.00€, interes në shumë prej 641.84€, shumë totale në vlerë prej 4,641.84€ dhe të njëjtën obligim për 36 muaj ta kthej me këste mujore shumë prej 128.94€.

4. Ligji i aplikueshëm

Në bazë të nenit 148 paragrafi 1 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i vitit 1978 (tutje LMD), parashihet që *“Kontrata krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese.”*

Në bazë të nenit 262 paragrafi 1 i LMD-së, parashihet që *“Kreditori në raportin e obliguar është autorizuar që prej debitorit të kërkojë mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta mbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij.”*

Në bazë të nenit 414 paragrafi 1 i LMD-së, parashihet që *“Secili debitor i detyrimit solidar i përgjigje kreditorit për krejt detyrimin dhe kreditori mund të kërkojë përmbushjen e tij nga cilido që dëshiron gjithnjë gjersa të mos përmbushet tërësisht, por kur një debitor ta ketë përmbushur detyrimin ai pushon dhe të gjithë debitorët shkarkohen.”*

5. Vlerësimet përfundimtare të gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe se duke u bazuar në dispozitat ligjore të cituara më lartë, e njëjta duhet të aprovohet.

Gjykata në bazë të provave të administruara, vërtetojë faktin se i padituri R.M në bazë të kontratës së Kredisë me numër 43 të datës 28.01.2005 është garantuesi i parë për kredinë e marrur nga kredimarrësi Ismet Imeri dhe ky i fundit tashmë ka vdekur dhe nuk e ka paguar kredinë e marrë. Duke marrë parasysh se i padituri është garantuesi i parë, në bazë të dispozitave të

lartëcekura të LMD-së i njëjti ka për obligim që të bëjë kompensimin e borxhit të cilin nuk e ka paguar kredimarrësi Ismet Imeri. Obligimi që ta paguaj këtë kredi, për të paditurin rrjedhe edhe nga vërtetimi i të dhënave për garantuesin e parë i datës 21.01.2005 ku i padituri deklaron se nga llogaria e tij do të paguhen të gjitha detyrimet e arritura të kredimarrësit pa kurrfarë procedure paraprake.

Gjykata, vlerëson se sipas planit të amortizimit të kredisë numër 43, kredia e marrë nga kredimarrësi është dashur të kthehet deri me datën 28.01.2008, mirëpo në bazë të provave të adminsituara, e njëjta nuk është paguar, andaj edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Lidhur me shpenzimet procedurale, gjykata vendosi komfor nenit 463 të LPK-së, duke marrë parasysh se paditësi nuk i kërkojë shpenzimet procedurale.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.1301/2023, datë 07.03.2024

Gjyqtari
Fuad Haliti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjës së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.